REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 960/20
Datë/Datum. 02.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. Nr.960/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Nuhi Paçarizi Panelist Individual, si dhe duke u bazuar në nenin 28 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, dhe nr. të protokollit 83/20 të dt: 03.03.2020, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 24 NËNTOR 2020, të parashtruar nga operatori ekonomik "TMS MOBILE" SH.P.K –Prishtinë, për tërheqje të ankesës me numër 960/20 të datës 17.11.2020,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e GPS-ëve ekzistues dhe furnizimi me GPS të ri" me nr te prok: 70433736-20-7499-2-2-1 iniciuar nga AK/ – "KUR-PRISHTINA" SH.A. me datën 02.12.2020, mori këtë:

VENDIM

I.APROVOHET, kërkesa e datës 24 NËNTOR 2020 e operatorit ekonomik "TMS MOBILE" SH.P.K – Prishtinë, për tërheqje të ankesës me numër 960/20 të datës 17.11.2020,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e GPS-ëve ekzistues dhe furnizimi me GPS të ri" me nr te prok: 70433736-20-7499-2-2-1 iniciuar nga AK/ – "KUR-PRISHTINA" SH.A.

II.NDËRPREHET, procedura e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik: "TMS MOBILE" SH.P.K –Prishtinë, pasi që ka parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës me numër 960/20 të datës 17.11.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e GPS-ëve ekzistues dhe furnizimi me GPS të ri" me nr te prok: 70433736-20-7499-2-2-1.

III.I LEJOHET, autoritetit kontraktues, që të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit përkitazi me këtë ankesë, ndërsa nëse ka ankesë tjetër, ajo vazhdon të shqyrtohet në mënyrë të rregullt dhe aktiviteti i prokurimit mbetet i pezulluar ashtu siç parashihet në nenin 112 paragrafi 1 të LPP-së.

IV. Meqenëse parashtruesi i ankesës tërhiqet nga ankesa para pranimit te raportit te ekspertit shqyrtues, në pajtim me nenin 28 të Rregullores së punës së OSHP-së, nr. 01/20 me numër te protokollit 83/20, këtij OE i bëhet kthimi i depozitës së parashtruar me rastin e Ankesës.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: "TMS MOBILE" SH.P.K –Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 17.11.2020, me nr. 960/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e GPS-ëve ekzistues dhe furnizimi me GPS të ri" me nr te prok: 70433736-20-7499-2-2-1 iniciuar nga AK/ – "KUR-PRISHTINA" SH.A duke pretenduar se AK-ja, ka bërë shkelje të dispozitave Nenin 28 pika 2 dhe 4, të Ligjit për Prokurim Publik te Kosovës.

Me datën 17.11.2020, është njoftuar autoriteti kontraktues nga OSHP-ja, për pranimin e ankesës së lartpërmendur në mënyre që të behet pezullimi i aktivitet të prokurimit në fjalë.

Operatori ekonomik: "AS TECH" SH.P.K -Prishtinë, me datën 24 Nëntor 2020, përmes email-it ka deponuar në OSHP, kërkesën për tërheqjen e ankesës, lidhur me tenderin me titull "Mirëmbajtja e GPS-ëve ekzistues dhe furnizimi me GPS të ri" me nr te prok: 70433736-20-7499-2-2-1 iniciuar nga AK/ – "KUR-PRISHTINA" SH.A,

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave,njoftimi për kontratë , ankesa e operatorit ekonomik, , kërkesën e OE ankues te datës 24.11.2020 dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues sqaron se "TMS MOBILE" SH.P.K –Prishtinë më datën 24.11.2020, përmes e-mail-it ka deponuar në OSHP, kërkesën për tërheqjen e ankesës së datës 17.11.2020, me nr. protokolli 960/20, lidhur me tenderin me titull: "Mirëmbajtja e GPS-ëve ekzistues dhe furnizimi me GPS të ri" me nr te prok: 70433736-20-7499-2-2-1 iniciuar nga AK/ – "KUR-PRISHTINA" SH.A.

Paneli shqyrtues pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, konstatoj se kërkesa e OE ankues për tërheqje nga ankesa me numër te protokollit 960/20, është dorëzuar në OSHP me datën 24.11.2020, periudhe kjo kohore në te cilën eksperti shqyrtues i prokurimit nuk e ka pasur ende në shqyrtim lenden.

Andaj OSHP aprovon kërkesën e OE ankues për tërheqje nga ankesa, dhe në pajtim me nenin 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës se OSHP-së nr. 01/20, me numër të protokollit 83/20, ankuesit i behet kthimi i tarifës së ankesës lidhur me ankesën me numër të protokollit 960/20 të datës 17.11.2020, nga fakti se ankuesi ka bere kërkesë për tërheqje nga ankesa para pranimit të raportit të ekspertizës ndërsa neni 28 paragrafi 1 i Rregullores së Punës se OSHP-së nr. 01/20, me numër të protokollit 83/20 specifikon:Pala mund ta tërheqë ankesën në çdo kohë. Në rast se ankesa tërhiqet para shqyrtimit të ankesës dhe/ose emërimit të ekspertit shqyrtues dhe para pranimit të akt-ekspertizës, do të bëhet kthimi i tarifës së ankesës. Në qoftë se ankuesi e tërheq ankesën pas emërimit të ekspertit shqyrtues dhe pranimit të akt-ekspertizës atëherë bëhet konfiskimi i tarifës në emër të shpenzimeve procedurale.

Paneli shqyrtues i OSHP-së, pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, të njëjtën e aprovoj si të bazuar, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetari i Paneli Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi i dërgohet:

1x1 AK-"KUR-PRISHTINA" SH.A".

1x1 OE-"TMS MOBILE" SH.P.K –Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim ne web faqe të OSHP-së.